



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 02 prot.

Kamëz, më 23.01 2023

V E N D I M
Nr 02 .Datë 23/01 2023
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2023”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 23.01.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.02 Datë 19.01.2023 Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 “Rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim”; Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti shtetit për programet e strehimit”; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.4 datë 17.01.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”; Vendimit nr.141 datë 25.11.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Manualit për programin e subvencionit të qirasë për Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, VKB nr 163 dt.21.12.2022 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2023, 2024, 2025”, shkresës me nr. Prot.13 dt. 04.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.383 Prot datë 16.01.2023; Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr.383/1 Prot datë 16.01.2023, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e trajtimit me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë një vjeçare duke filluar nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2023.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 *do të përballohen me bashkëfinancim në raportin 80% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe 20% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.*
4. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.

Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYEPARKËSHILLI

Hysen KOLDASHI

